

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i ndryshimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligativ (O)
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Arbresha Meha
Detajet kontaktuese:	arbresha.meha@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës	
Përshkrimi i lëndës	Lëndë Menaxhimi i ndryshimeve u ofron studentëve një hyrje në parimet e menaxhimit të ndryshimit në organizata duke përfshirë stile të ndryshme të të menduarit në lidhje me menaxhimin e ndryshimit, parimet bazë që zbatohen për çdo proces kompleks ndryshimi dhe aplikimi praktik se si të punojmë me individë, ekipe dhe organizata për të zotëruar ndryshimin. Lënda do të shqyrtojë në mënyrë kritike teorinë dhe praktikën aktuale për të krijuar strategji dhe plane të menaxhimit të ndryshimit që rrisin miratimin dhe përdorimin në projektet dhe iniciativat kritike të ndryshimeve.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që të përgatisë studentët me njohurit e duhura mbi procesin e menaxhimit të ndryshimit, sfidave për të ndryshuar, modelet që duhen ndjekur për të menaxhuar ndryshimin, nismat e ardhshme të ndryshimit, dhe strategjitë e komunikimit në lidhje me ndryshimin dhe konsolidimin e ndryshimit në organizatë. Synohet që studentët të njihen me llojet e iniciativave të ndryshimit, proceset, mjetet dhe vlerësimet për ti aplikuar në projekte dhe organizata, si dhe ndërtimin e aftësitë individuale dhe organizative të menaxhimit të ndryshimeve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • shpjegojë se çfarë është ndryshimi, pse është sfidues për organizatat, identifikoj ndryshimet e përbashkëta me të cilat përballen organizatat dhe përshkruaj rolin e forcave të brendshme dhe të jashtme në ndryshimin organizativ; • përshkruajë qasjet për menaxhimin dhe lehtësimin e ndryshimit individual dhe organizativ dhe shpjegoj rëndësinë e

	<p>përdorimit të një modeli në procesin e ndryshimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvilloj aftësi dhe shkathtësi menaxheriale për secilën fazë të procesit të menaxhimit të ndryshimeve; • kuptoj dallimet themelore midis qasjeve evolucionare dhe revolucionare në menaxhimin e ndryshimeve organizative. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Mësimi teorik dhe praktik	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren	2	4	8
Kollokfiume,seminare	4	1	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgaditja përfundimtare për provim	3	15	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	3	18
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Lënda zhvillohet në 15 javë me ngarkesë 2 orë ligjerata në të cilat do të trajtohen konceptet teorike dhe do të ipen sqarime lidhur menaxhimin e ndryshimeve, si dhe 1 orë ushtrime në grupe në javë. Ushtrimet do të zhvillohen në formë me grupe në të cilat do të diskutohen shembuj konkret. Kjo mënyrë e organizimit të ushtrimeve do t'ju shërbejë studentëve për të përvetësuar konceptet teorike dhe për ta lidhur teorinë me aspektet praktike në ndërtimin e aftësitë individuale dhe organizative të menaxhimit të ndryshimeve.</p> <p>Studentët do t'i nënshtrohen vlerësimit në fund të ciklit të plotë të këtij kursi me caktimin e rasteve studimore dhe provimin përfundimtar.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Provimi 60% (provimi përfundimtar do të përbëhet nga pyetje me zgjedhje të shumëfishta dhe të hapura).</p> <p>Punimi seminarik 40% (një analizë e rastit studimor).</p>		
Literatura			

Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ian Palmer, Richard Dunford and Gib Akin "Managing Organizational Change: a multiple perspectives approach, 3rd edition, 2017. 2. Sergio Caredda "Models: the ADKAR Change Management Model", 2020
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Jeffrey Hiatt, Timothy Creasey "Change Management: The People Side of Change", 2012.

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në konceptet themelore dhe materialet që do të ligjërohen; Udhëzues për detyrën (rast studimi).
<i>Java e dytë:</i>	Menaxhimi i ndryshimi – konceptet dhe qasjet
<i>Java e tretë:</i>	Procesi i menaxhimit të ndryshimeve sipas modelit ADKAR
<i>Java e katërt:</i>	Ndryshimet individuale, grupore/ekipore
<i>Java e pestë:</i>	Ndryshimet organizative dhe strategjike - Procesi 3-fazor
<i>Java e gjashtë:</i>	Nxitësit dhe kundërshtarët e menaxhimit të ndryshimeve
<i>Java e shtatë:</i>	Strategjitë dhe taktikat e menaxhimit të ndryshimit
<i>Java e tetë:</i>	Teknologjia informatike gjatë menaxhimit të ndryshimit
<i>Java e nëntë:</i>	Përgjegjësia shoqërore gjatë menaxhimit të ndryshimeve
<i>Java e dhjetë:</i>	Kultura, politika dhe lidërimi i ndryshimeve në organizata
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Menaxhimi i ndryshimit, procesi dhe qasjet e paparashikuara
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Zbatimi i ndryshimit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Strategjitë dhe aftësitë për të komunikuar ndryshim
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Qëndrueshmëria dhe menaxhimi efektiv i ndryshimeve
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përsëritje dhe Punë Praktike dhe përgatitja për provimin final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.